



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1025/11 prot

Datë 18.05.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 662/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 18.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 564/2026, datë 29.04.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-73740-01-09-2026, me objekt: “Blerje lëndë djegëse për përdorim teknik, civil dhe industrial”, me fond limit 54,999,962 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “RESULI - ER” SHA, me NUIS L12510413V, me adresë: Lagjja Mbrostar Ferko, rruga Baltës banesa nr-53, zone kadastrale nr-3980 numer pasurie nr- 62/24, Fier

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, me adresë: Rruga “5 Maji” , Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 29.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 564/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “RESULI-ER” SHA, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-73740-01-09-2026, me objekt: “Blerje lëndë djegëse për përdorim teknik, civil dhe industrial”, me fond limit 54,999,962 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të kthejë për rivlerësim procedurën dhe të ndjekë hapat proceduralë që parashikon neni 93 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar për trajtimin e ofertës anomalisht të ulët të operatorit ekonomik “Trios” SHA.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Resuli-Er” SHA,.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.5947/15 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1025/8 prot., datë 06.05.2026, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 564/2026, datë 29.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

**II**

**Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

## Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.5947/15 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1025/8 prot., datë 06.05.2026, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 564/2026, datë 29.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 564/2026, datë 29.04.2026 të KPP-së. Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 564/2026, datë 29.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me arsyetimet e konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-73740-01-09-2026, me objekt: “Blerje lëndë djegëse për përdorim teknik, civil dhe industrial”, me fond limit 54,999,962 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar  
Kreshnik Ternova

Anëtar  
Gjergj Mersini

Nënkryetar  
Fiorent Zguro

